

**Kosovë KEK  
Prishtinë, Kosovë**

***Përmbledhje***

Kompania Energjitike e Kosovës (KEK) është kompania e shërbimeve komunale me pronësi shtetërore në Kosovë. Në 2009, Korporata Ndërkombëtare e Financës (IFC) aprovoi një projekt Shërbimesh Këshillimore (SHK) për të ndihmuar Qeverinë e Kosovës (QeK) në lidhje me privatizimin e mundshëm të KEK nëpërmjet pjesëmarrjes së sektorit privat (PSP).

Në gusht 2011, CAO mori një ankesë në lidhje me projektin e Shërbimeve Këshillimore të IFC dhe ndikimin e tij të mundshëm në privatizimin e KEK. Ankuesit kërkuan që identiteti i tyre të mbahej i fshehtë dhe ankesa u mbështet (bashkë-firmos) nga disa Organizata Jo-Qeveritare vendase (kosovare) dhe ndërkombëtare. Ankesa ngrinte një numër problemesh, ku përfshiheshin humbja e vendeve të punës si rezultat i privatizimit; ndikimet negative mbi të drejtat dhe lirinë e mbledhjes; pretendimet se IFC nuk ka përbushur Politikën e saj mbi Qëndrueshmërinë Sociale dhe Ambjentale dhe Politikën mbi Shpërndarjen e Informacionit; pretendimet se IFC nuk ka siguruar në mënyrë të përshtatshme mundësinë e përdorimit të informacionit në lidhje me procesin e privatizimit dhe aftësinë e klientit për t'iu përgjigjur ndikimeve negative të projektit; dhe pretendimet se IFC nuk ka siguruar që klienti (QeK) t'iu përmbahej gjatë privatizimit Standarteve përkatëse të Punës.

Dokumentacioni i shqyrtuar nga CAO tregon që IFC ka ndjekur procedurat përkatëse brenda përcaktimeve të saj në lidhje me objektivat e projektit të Shërbimeve Këshillimore. Megjithatë, nuk është e qartë nëse ekzistojnë udhëzime të përshtatshme nëpërmjet të cilave të sigurohet që IFC t'i përcaktojë drejt synimin (objektivat) e projektit të Shërbimeve Këshillimore dhe objektivat e procesit të masave të kujdesit të arsyeshëm (verifikimit) në mënyrë që rezultatet e Shërbimeve Këshillimore të përputhen me efektet e dëshiruara nga dispozitat e politikës së IFC. Për këtë arsye, CAO është e mendimit se një kontroll i përbushjes do të jepte informacion apo të dhëna të mëtejshme që mund të informonin më mirë IFC në lidhje me nevojën e udhëzimeve për stafin dhe aplikimin e politikave në projektet e ardhshme të IFC për Shërbime Këshillimore. Në përputhje me Udhëzimet Operative të CAO, CAO do të hartojë Termat e Referencës dhe do të kryejë një kontroll të IFC në lidhje me qëllimin dhe mandatin, dhe me objektivat e procesit të masave të (verifikimit) të arsyeshëm të projektit të Shërbimeve Këshillimore të IFC për Qeverinë e Kosovës. CAO nuk kontrollon klientët e IFC; kështu që CAO nuk do të japë mendim në lidhje me punën e klientit të IFC, por do të marrë në konsideratë dhe shqyrtim vetëm çështjet që kanë të bëjnë me IFC.

Zyra e Këshilltarit të Përbushjes/Avokatit të Popullit (CAO)  
për  
Korporatën Ndërkombëtare të Financës (IFC)  
Agjencinë e Garantimit të Investimeve Multilaterale (MIGA)  
Anëtarëve të Bankës Botërore

## Pasqyra e Lëndës

1. Vështim i Përgjithshëm mbi Proçesin e Shqyrtimit dhe Kontrollat e Përmbushjes të CAO
2. Të dhënat dhe Shqetësimet që Rezultuan nga Kryerja e Vlerësimit
3. Synimi i Vlerësimit për një Kontroll Përmbushjeje në IFC
4. Konkluzionet e Vlerësimit të CAO
5. Vendimi i CAO

## Informacion mbi CAO

*Misioni i CAO është që të shërbejë si një mekanizëm burimor i drejtë, i besuar, efektiv dhe i pavarur dhe të përmirësojë përgjegjësinë ambientale dhe sociale të IFC dhe MIGA.*

CAO (Zyra e Këshilltarit të Përmbushjes/Avokatit të Popullit) është një pozicion i pavarur që varet direkt nga Presidenti i Grupit të Bankës Botërore. CAO shqyrton ankesat e paraqitura nga komunitetet që ndikohen nga projektet e zhvillimit të ndërmarra nga dy krahët huadhënës të sektorit privat të Grupit të Bankës Botërore: Korporata Ndërkombëtare të Financës (IFC) dhe Agjencia e Garantimit të Investimeve Multilaterale (MIGA).

Për informacion të mëtejshëm në lidhje me CAO, ju lutemi vizitoni [www.cao-ombudsman.org](http://www.cao-ombudsman.org).

## 1. Vështim i Përgjithshëm mbi Proçesin e Vlerësimit dhe Kontrollat e Përbushjes të CAO

Kur CAO merr një ankesë në lidhje me një projekt të IFC apo MIGA, ankesa i kalohet fillimisht rolit të avokatit të popullit në CAO, *Avokati i Popullit në CAO*, i cili punon për t'iu përgjigjur ankesës shpejt dhe me efektivitet nëpërmjet lehtësimit të zgjidhjes së çështjes me marrëveshje, në rast se kjo është e përshtatshme. Në rast se Avokati i Popullit në CAO konstaton se palët nuk kanë dëshirë apo mundësi të arrijnë një zgjidhje nëpërmjet proçesit të lehtësimit (bashkëpunimit), ankesa i kalohet rolit të përbushjes në CAO, *Përbushja në CAO*, për të shqyrtuar shqetësimet e ngritura në ankesë si bazë e një *kontrolli përbushjeje* të IFC apo MIGA. Në mënyrë alternative, një kontroll përbushjeje mund të fillohet me kërkesën e Presidentit të Grupit të Bankës Botërore apo drejtuesve të lartë të IFC apo MIGA, apo me vendim të Zv. Presidentit të CAO.

*Vlerësimi i përbushjes* nga CAO është një shqyrtim paraprak për të përcaktuar nëse CAO duhet të kryejë një kontroll përbushjeje të IFC/MIGA. Nëpërmjet vlerësimit të përbushjes, CAO siguron që kontrollat e përbushjes në IFC/MIGA të fillohen vetëm në ato raste që mund të ngrejnë shqetësime thelbësore në lidhje me rezultatet sociale apo ambjentale.

Kontrolli i përbushjes ka të bëjë me vlerësimin e aplikimit të dispozitave politike dhe udhëzimeve e procedurave përkatëse për të përcaktuar nëse IFC/MIGA kanë vepruar në përputhje me to. Fokusi kryesor i kontrollit të përbushjes është mbi IFC/MIGA, por mund të merret në konsideratë edhe roli i sponsorit.

Vlerësimi për kontrollin e përbushjes, dhe kontrolli që mund t'a pasojë, duhet të mbeten brenda qëllimit (objektivave) të ankesës apo kërkesës fillestare. Ai nuk mund t'i kalojë kufijtë e ankesës apo kërkesës dhe të shqyrtojë probleme të tjera. Në këto raste, ankuesi apo kërkuesi duhet të konsiderojnë paraqitjen e një ankese apo kërkesë të re.

Vlerësimi i përbushjes i CAO do të marrë parasysh se si IFC/MIGA sigurojnë vetveten në lidhje me përputhjen me legjislacionin kombëtar, ku përfshihen edhe angazhimet ligjore ndërkombëtare, dhe kriteret e tjera vlerësimi. CAO nuk ka kompetenca në lidhje me proçeset gjyqësore. CAO nuk është gjykatë apeli apo një mekanizëm ligjor imponimi, dhe as nuk zëvendëson sistemin e gjykatave ndërkombëtare apo sistemet gjyqësore në vendet pritëse.

Kriteret e vlerësimit janë përcaktuar në Udhëzimet Operative të CAO. Kriteret janë paraqitur si një seri pyetjesh për të testuar vlerën e kryerjes së një kontrolli përbushjeje të IFC apo MIGA. Këto kriteret janë si më poshtë:

- A ka prova (apo perceptim rreziku) të efekteve ambjentale dhe sociale të padëshiruara që tregojnë se mund të ketë patur mospërputhje apo aplikim të papërshtatshëm të dispozitave politike (apo kriterëve të tjera të kontrollit)?
- A ka prova të mundësisë së efekteve të rëndësishme ambjentale dhe sociale të padëshiruara që tregojnë se dispozitat politike, pavarësisht nga fakti nëse është vepruar në përputhje me to ose jo, nuk kanë arritur të sigurojnë një nivel të përshtatshëm mbrojtjeje?
- A ka prova (apo perceptim rreziku) të efekteve të rëndësishme ambjentale dhe sociale të padëshiruara ku dispozitat politike, standartet, apo kriteret e tjera të kontrollit mendohej se nuk ishin të aplikueshme por ndoshta mund të ishin aplikuar?

- A ka prova që aplikimi i disa aspekteve të një politike, standarti, udhëzimi apo procedurë ka rezultuar në efekte ambjentale dhe sociale të padëshiruara?
- A ka mundësi që shkak i efekteve ambjentale dhe sociale të padëshiruara të mos mund të identifikohet dhe korrigjohet me shpejtësi nëpërmjet ndërhyrjes së ekipit të projektit dhe pa nevojën e një hetimi të hollësishëm të shkaqeve dhe rrethanave?
- A është e mundur që kontrolli i përmbushjes të japë informacion apo konkluzione që mund të informojnë më mirë në lidhje me aplikimin e politikave (apo kritereve të tjera të kontrollit) në projektet e ardhshme?

Në kryerjen e vlerësimit, Përmbushja në CAO organizon diskutime me ekipin e projektit të IFC/MIGA dhe palë të tjera të përshtatshme për të kuptuar vlerën e shqetësimeve dhe për të konstatuar nëse kontrolli është përgjigjia e përshtatshme.

Mbas kryerjes së vlerësimit të përmbushjes, CAO mund të zgjedhë midis dy alternativave: të mbylli çështjen apo të fillojë kontrollin e përmbushjes të IFC/MIGA.

CAO i raporton dhe shpërndan konkluzionet dhe vendimin e vlerësimit të përmbushjes në CAO në një raport vlerësimi, nëpërmjet të cilit informon me shkrim Presidentin e Grupit të Bankës Botërore, Bordet e Grupit të Bankës Botërore, drejtuesit e lartë të IFC/MIGA dhe publikun në lidhje me vendimin e marrë.

Kur CAO vendos që në bazë të konstatimeve të bëra në vlerësimin e përmbushjes të fillojë një kontroll përmbushjeje, CAO harton Termat e Referencës për kontrollin në përputhje me Udhëzimet Operative të CAO.

## 2. Të dhënat dhe Shqetësimet që Rezultuan nga Kryerja e Vlerësimit

Në 15 gusht 2011, CAO mori një ankesë (korrespondencë) nga ankues që kërkuan që identiteti i tyre të mbahej i fshehtë. Ankesa u mbështet (bashkë-firmos) nga disa Organizata Jo-Qeveritare vendase (kosovare) dhe ndërkombëtare dhe ngrinte një numër problemesh në lidhje me projektin e Shërbimeve Këshillimore të IFC dhe efektet e tij mbi privatizimin e Kompanisë Energjitike e Kosovës (KEK), kompania e shërbimeve komunale me pronësi shtetërore në Kosovë. Ankuesit pretendonin që privatizimi i KEK ngre shqetësime të rëndësishme sociale dhe ambientale, ku përfshiheshin humbja e vendeve të punës si rezultat i privatizimit; ndikimet negative mbi të drejtat dhe liritw e mbledhjes; pretendimet se IFC nuk ka përmbushur Politikën e saj mbi Qëndrueshmërinë Sociale dhe Ambientale dhe Politikën mbi Përhapjen e Informacionit; pretendimet se IFC nuk ka siguruar në mënyrë të përshtatshme mundësinë e përdorimit të informacionit në lidhje me procesin e privatizimit dhe aftësinë e klientit për t'iu përgjigjur ndikimeve negative të projektit; dhe pretendimet se IFC nuk ka siguruar që klienti (QeK) t'iu përmbahej gjatë privatizimit Standarteve përkatëse të Punës.

Në shtator 2011 CAO e konsideroi ankesën të kualifikueshme për vlerësim dhe Avokati i Popullit në CAO filloi vlerësimin e mundësive për zgjidhjen e problemve të ngritura në ankesë. Ekipi i CAO bëri dy vizita në Kosovë në nëntor 2011 për t'u takuar me palët e interesuara në vend. Gjatë këtyre vizitave, ekipi i CAO u takua me ankuesit, ekipin e projektit të IFC, zyrtarë qeveritarë, OJQ vendase dhe ndërkombëtare dhe palë të tjera të interesuara.

Avokati i Popullit në CAO arriti në përfundimin që palët nuk kishin dëshirë apo nuk ishin në gjendje të arrinin një zgjidhje me bashkëpunim, duke ia kaluar kështu çështjen për vlerësim funksionit të Përmbushjes.

### ***Informacion i Përgjithshëm mbi Investimin***

Projekti i Shërbimeve Këshillimore (SHK) kishte për qëllim të ndihmonte Qeverinë e Kosovës në lidhje me privatizimin e mundshëm të KEK nëpërmjet pjesëmarrjes së sektorit privat (PSP). Projekti i SHK ka dy faza. Faza e parë ishte shqyrtimi i mundësisë dhe praktikitetit të prezantimit të pjesëmarrjes së sektorit privat në rrjetin e shpërndarjes dhe funksionet e furnizimit të KEK. Mbas përcaktimit se PSP ishte i mundshëm nga perspektiva e tregut dhe me përfitim për vendin, faza e dytë përfshinte kryerjen e një procesi transparent tenderimi për të tërhequr një investitor privat me fondet dhe ekspertizën e nevojshme për të korrigjuar dështimet operative të KEK (nivele tepër të larta stafi, menaxhim i papërshtatshëm, paisje të vjetëruara) dhe problemet financiare (kryesisht si pasojë e niveleve të ulta të vjeljes).<sup>1</sup> Në përputhje me procedurat e IFC për klasifikim, IFC e klasifikoi projektin e Shërbimeve Këshillimore si rrezik mesatar.

<sup>1</sup> Korporata Ndërkombëtare e Financës (IFC), KEK Kosovë Përmbledhje e projektit të Shërbimeve Këshillimore, <http://www.ifc.org/ifcext/spiwebsite1.nsf/b1e2a5a8fc40cd238525753d00658ca9/852568b10055270d852576b0007a3338?opendocument&Highlight=0.kosovo>

### 3. Qëllimi i Vlerësimit për Kontrolli Përbushjeje në IFC

Siç diskutohet në Seksionin 1, vlerësimet kufizohen në shqyrtimin e çështjeve të ngritura në ankesë dhe në përcaktimin e lidhjes së këtyre çështjeve me rezultatet e punës së IFC/MIGA dhe detyrimet e saj sipas standarteve, udhëzimeve, procedurave dhe politikave përkatëse. Qëllimi i vlerësimit të përbushjes përfshin: procesin e masave të kujdesit të arsyeshëm (verifikimit) të IFC dhe nëse ky është në përputhje me proceset dhe politikat e IFC; përcaktimin nga IFC të synimit dhe objektivave të procesit të masave të kujdesit të arsyeshëm (verifikimit) dhe nëse ky përcaktim është në përputhje me dispozitat e politikave të IFC.

#### *Proçesi i masave të kujdesit të arsyeshëm (verifikimit) i IFC*

Ankesa ngrinte një numër problemesh sociale dhe ambjentale në lidhje me procesin e privatizimit.

- Proçesi i masave të kujdesit të arsyeshëm (verifikimit) ambjental dhe social: Ankuesit pretendonin që studimet e efekteve sociale dhe ambjentale të rolit këshillimor të IFC dhe efekteve të mëpasshme mbi sektorin energjitik ishin të pamjaftueshme. Në mënyrë specifike, ankuesit pretendonin që projekti i Shërbimeve Këshillimore të IFC nuk është kryer në përputhje me Standartet e Punës të IFC Nr. 1 (Sistemet e Vlerësimit dhe Menaxhimit Social dhe Ambjental) dhe Nr. 2 (Kushtet e Punësimit dhe të Punës), dhe se nuk ishin marrë në konsideratë implikimet sociale dhe ambjentale të objekteve që kishin lidhje me to dhe që ndikonin mbi privatizimin e KEK (sidomos një minierë qymyri linjit dhe një termocentral).
- Shkurtime në punësim dhe të drejtat (liria) e mbledhjes: Ankuesit shprehën shqetësim se privatizimi do të sillte si rezultat humbjen e vendeve të punës (shkurtime në punësim) në sektorin e shërbimeve komunale edhe më gjerësisht në sektorin energjitik dhe se planet për këto shkurtime janë të pamjaftueshme. Ata shpreheshin gjithashtu se privatizimi do të ndikonte për keq edhe mbi të drejtat (lirinë) e mbledhjes.
- Legjislacioni kombëtar dhe rajonal: Shpreheshin shqetësime se projekti i Shërbimeve Këshillimore i IFC dhe efekti rezultativ mbi masat e QeK në lidhje me privatizimin mund të binin në kundërshtim me legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar si dhe me konventat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ONP) që garanton të drejtat e punësimit dhe mbledhjes, si dhe me udhëzimet e Këshillit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut në lidhje me të drejtat e biznesit dhe të drejtat e njeriut.<sup>2</sup>
- Përhapja e informacionit dhe konsultimet me komunitetin: Ankuesit pretendonin se përhapja e informacionit në lidhje me përfshirjen e IFC në privatizimin e KEK dhe procesin e privatizimit ishin të pamjaftueshme dhe nuk janë kryer në kohën e duhur. Ata mendonin se palëve të interesuara nuk iu është dhënë informacion i përshtatshëm në lidhje me rreziqet ekonomike, ambjentale dhe sociale që shoqërohen me privatizimin e KEK, apo alternativat e mundshme për lehtësimin e këtyre rreziqeve. Ata mendonin se kjo përbën mospërputhje me Politikat e IFC mbi Përhapjen e Informacionit. Ankuesit shprehen gjithashtu se konsultimet për të gjithë projektin e SHK të privatizimit ishin të pamjaftueshme dhe duhet të ishin më përfshirëse dhe më të gjera. Ata shprehen se konsultimet nuk u bënë përgjatë fazave të vlerësimit dhe seleksionimit të projektit të SHK.

<sup>2</sup> <http://www.business-humanrights.org/media/documents/ruggie/ruggie-guiding-principles-21-mar-2011.pdf>

### *Synimi (Objektivat) e IFC*

Vlerësimi i CAO mori në shqyrtim gjithashtu edhe përmasat në të cilat IFC është vetësiguruar që udhëzimet që i jep stafit të saj në përcaktimin e synimit (objektivave) të punës së projektit të Shërbimeve Këshillimore të ishin në përputhje me politikat e saj më të gjera sociale dhe ambientale. Për këtë qëllim, vlerësimi mori në konsideratë edhe sa më poshtë:

- Synimin (objektivat) e Shërbimeve Këshillimore të IFC për Qeverinë e Kosovës: Vlerësimi i CAO mori në shqyrtim në mënyrë specifike procedurat dhe udhëzimet për përcaktimin e synimit (objektivave) të një projekti për Shërbime Këshillimore me qëllim që të kuptonte përmasat në të cilat ishte marrë në konsideratë kuadri i politikave të IFC gjatë procesit të IFC për përcaktimin e synimit (objektivave) të projektit dhe konsideratat për implikimet që do të rezultonin si për objektet që lidheshin me projektin ashtu dhe për vetë rezultatet e projektit. Duke u bazuar në Udhëzimet Operative të saj, CAO i përfshiu këto pyetje në përkufizimin e synimit (objektivave) të vlerësimit të CAO. Udhëzimet Operative të CAO parashikojnë që çështja që shtrohet është nëse:
  - Rezultatet aktuale sociale apo ambientale janë në përputhje apo në kundërshtim me efektet e dëshiruara nga dispozitat e politikave;
  - Moszgjidhja e çështjeve sociale apo ambientale si pjesë e procesit të shqyrtimit rezultoi në rezultate që bien në kundërshtim me efektet e dëshiruara nga dispozitat e politikave.

### ***Standartet, Udhëzimet dhe Procedurat e IFC***

Procedurat e Shqyrtimit Ambientale dhe Social kërkojnë që IFC të shqyrtojë projektet në bazë të Standarteve të Punës dhe standarteve të praktikave më të mira ndërkombëtare, siç përcaktohet në Udhëzimet Ambientale, Shëndetësore dhe të Sigurisë (ASHS). Përveç kësaj, ky vlerësim përfshin në mënyrë tipike një shqyrtim të eksperiencës, kapacitetit teknik, sistemeve korporative dhe sistemeve specifike të menaxhimit të projektit tek klienti/operatori, si dhe masat lehtësuese për rreziqet e biznesit dhe ato teknike apo rreziqet e tjera shoqëruese.

Kuadri i procesit të masave të kujdesit të arsyeshëm (verifikimit) të IFC për projektet e Shërbimeve Këshillimore përcaktohet nga Kërkesat Sociale dhe Ambientale për Shërbimet Këshillimore të Veçanta.

### ***Proçesi i masave të kujdesit të arsyeshëm (verifikimit) të IFC dhe Ndjekja***

Në 2009, Shqyrtimi Paraprak i Dokumentit Përmbledhës të Projektit (DPP) të IFC për projektin e Shërbimeve Këshillimore të KEK dhe Aprovimi i PDD për Shërbimet Këshillimore identifikoi një numër rreziqesh ambientale dhe sociale të shoqëruara me projektin e SHK:

- Mekanizmat e dobët të monitorimit ambientale në Kosovë. IFC u shpreh se do të punonte me institucione të tjera financiare ndërkombëtare (IFN) me prezencë në Kosovë për të promovuar zhvillimin dhe aplikimin e mekanizave të monitorimit ambientale;
- Ekzistonin rreziqe ambientale për arsye se 80% e prodhimit të energjisë elektrike realizohej nga linjitet (qymur i murmë). Megjithatë, si një efekt pozitiv i privatizimit, IFC mendonte se



PSP do të kontribuonte në reduktimin e humbjeve në shpërndarje, duke reduktuar kështu në mënyrë të pjesshme nivelin e përgjithshëm të emetimeve të CO<sub>2</sub>;

- Nivelet e larta të stafit të KEK nënkuptonin që shkurtimet e vendeve të punës ishin të pashmangshme për të arritur një operacion fitimprurës. Për këtë arsye, IFC rekomandoi që të ndiqeshin udhëzimet e IFC në lidhje me shkurtimet në punësim.

Specialistët e departamentit për Ambjentin, Çështjet Sociale dhe Qeverisjen në IFC (ASQ) organizuan konsultime për identifikimin e rreziqeve dhe hartimin e treguesve të monitorimit dhe vlerësimit (M&V), nëpërmjet të cilave do të ndiqej progresi i bërë në drejtim të lehtësimit të rreziqeve që shoqëroheshin me Shërbimet Këshillimore.

Në shkurt 2011, si pjesë e procesit të masave të arsyeshme të saj, IFC kontraktoi një palë të tretë të jashtme për të kryer një vlerësim të problemeve ambientale. Raporti identifikoi fushat e mëposhte prioritare ku mendohej se kishte nevojë për vlerësim të mëtejshëm për të kuptuar natyrën e rreziqeve ambientale, shëndetësore dhe të sigurisë që shoqëroheshin me punën e KEK në aktivitetin e shpërndarjes:

- Kabllot e mbushura më lëng
- Shkarkimet në ujë
- Toka e infektuar
- Menaxhimi i PCB
- Menaxhimi i plehrave (përfshi dhe menaxhimin e azbestos)
- Rreziku i përmbytjes

Këto konstatime u përfshinë në dokumentacionin e vlerësimit të IFC, i cili përforcoi gjithashtu shqetësimet e theksuara në vlerësimet e kryera gjatë Shqyrtimit Paraprak dhe Aprovimit të PDD. Në Memorandumin e Efekteve Sociale dhe Ambientale të projektit të SHK, IFC arriti në përfundimin se vlerësimet e kryera jepnin informacion të mjaftueshëm për të siguruar që tenderuesi i mundshëm për projektin e KEK të dinte cilat ishin rreziqet A&S. IFC rekomandoi që tenderuesi të kryente projektin në përputhje me udhëzimet Ambientale, Shëndetësore dhe të Sigurisë; të implementonte një sistem formal dhe të dokumentuar menaxhimi ambiental, shëndetësor, të sigurisë dhe social; dhe të adoptonte dhe implementonte udhëzimet e IFC për shkurtimet në punësim.

Raportet fillestare të IFC për mbikqyrjen e SHK, të cilat filluan në tre-mujorin e katërt të vitit 2010, tregojnë që IFC u fokusua tek rreziqet mbi reformat tarifore, modelet e tregut dhe informacionin nga investitori. Në tre-mujorin e katërt të vitit 2011, raportet e IFC për mbikqyrjen e SHK vërejnë angazhimin në rritje të organizatave vendase të shoqërisë civile (OSHC) dhe OJQ-ve në Kosovë të cilat dëshironin të përfshiheshin në vlerësimin e strategjisë për privatizimin e KEK dhe efektet e këtij privatizimin në Kosovë.

#### 4. Konkluzionet e Vlerësimit të CAO

- Proçesi i masave të kujdesit të arsyeshëm (verifikimit) ambiental dhe social: Dokumentacioni i IFC tregon se rreziqet ambientale dhe sociale të ngritura më pas nga ankuesit ishin identifikuar në vlerësimet e projektit të SHK të kryera nga IFC.

- Shkurtime në punësim dhe e të drejtat (liria) e mbledhjes: Dokumentacioni i IFC tregon se vlerësimet e projektit të SHK të kryera nga IFC identifikuan rrezikun për shkurtime në punësim. Vlerësimet fillestare nuk theksuan në mënyrë specifike të drejtat (lirinë) e mbledhjes si një rrezik i mundshëm i shoqëruar me projektin e SHK apo privatizimin.
- Legjislacioni kombëtar dhe rajonal: Vlerësimet fillestare të projektit të SHK të kryera nga IFC nuk theksonin në mënyrë specifike mospërputhjen me legjislacionin kombëtar dhe rajonal si rrezik të mundshëm. Megjithatë, në komunikimet e mëpasshme me OJQ-të vendase në Kosovë, IFC shprehet se është vetësiguruar që projekti i Shërbimeve Këshillimore ishte në përputhje me legjislacionin rajonal.
- Përhapja e informacionit dhe konsultimet me komunitetin: Vlerësimet fillestare të projektit të SHK të kryera nga IFC nuk theksonin në mënyrë specifike përhapjen e informacionit dhe konsultimet me komunitetin si probleme shqetësuese. Megjithatë, në komunikimet e mëpasshme me OJQ-të vendase në Kosovë, IFC shprehet se është përpjekur të krijojë komunikim midis Qeverisë së Kosovës dhe publikut nëpërmjet inkurajimit të QeK që nëpërmjet OJQ-ve të informonte publikun në lidhje me modelin e biznesit për privatizimin.
- Synimi (objektivat) e Shërbimeve Këshillimore të IFC për Qeverinë e Kosovës. Vlerësimi i CAO konstatoi mundësinë e udhëzimeve të pamjaftueshme për stafin në lidhje me vendimet e tyre që kanë të bëjnë me përcaktimin e synimit (objektivave) të projektit të Shërbimeve Këshillimore dhe përmasat në të cilat udhëzimet në lidhje me përcaktimin e këtij synimi janë në përputhje me politikat më të gjera të IFC për qëndrueshmërinë.

## 5. Vendimi i CAO

Nuk është e qartë nëse ekzistojnë udhëzime të përshtatshme nëpërmjet të cilave të sigurohet që IFC t'i përcaktojë drejt synimin (objektivat) e projektit të Shërbimeve Këshillimore dhe objektivat e procesit të masave të kujdesit të arsyeshëm (verifikimit) në mënyrë që rezultatet e Shërbimeve Këshillimore të përputhen me efektet e dëshiruara nga dispozitat e politikës së IFC. Për këtë arsye, CAO është e mendimit se një kontroll i përmbushjes do të jepte informacion apo të dhëna të mëtejshme që mund të informonin më mirë IFC në lidhje me nevojën e udhëzimeve për stafin dhe aplikimin e politikave në projektet e ardhshme të IFC për Shërbime Këshillimore. Në përputhje me Udhëzimet Operative të CAO, CAO do të hartojë Termat e Referencës dhe do të kryejë një kontroll të IFC në lidhje me qëllimin dhe mandatin, dhe me objektivat e procesit të masave të kujdesit të arsyeshëm (verifikimit) të projektit të Shërbimeve Këshillimore të IFC për Qeverinë e Kosovës.

CAO kontrollon IFC dhe metodat e përdorura nga IFC për t'u vetësiguruar në lidhje me ndikimet ambientale dhe sociale të investimeve dhe projekteve të saj. Ky kontroll do të fokusohet mbi IFC dhe mbi faktin nëse proceset dhe procedurat e aplikuara nga IFC janë të bazuara dhe në përputhje me dispozitat më të gjera të politikave të IFC. CAO nuk kontrollon klientët e IFC; kështu që CAO nuk do të japë mendim në lidhje me punën e klientit të IFC.